REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE E ÇËSHTJEVE TË DREJTËSISË
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROFESIONEVE TË LIRA
SEKTORI I MONITORIMIT TË PROFESIONEVE TË TJERA TË LIRA

Nr. 207 prot. Tiranë, më 12.01.2023

Lënda: Për njohje dhe Zbatim

RE/MAX ADVANTAGE 1
Rruga "Ibrahim Rugova", përballë Kompleksit Taiwan, Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX ALPHA
Rruga "Siri Kodra", Siri Kodra, Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX ART
Pallati "Aurora", Don Bosko, Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX EMPIRE
Sheshi "Karl Topia", pranë "Bar Trinity", Zogu i Zi, Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX FRIENDS
Rruga "Bardhok Biba", Pallati Trema, Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX GOLDEN
Rruga "Sami Frashëri", përballë Juvenilja Bllok, Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX GOLDEN PRO
Rruga "Faik Konica", Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX GREEN PARTNERS
Rruga "Teodor Keko", Astir, Unaza e Re, Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX HOME GROUP
Rruga "Sami Frasheri", Pall 11, Sh 4, Kati 1, Apt. 3, Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX INFINITY PLUS
Rruga "Sami Frasheri", Kompleksi Nobis, Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX KONCEPT 1
Rruga "Ismail Qemali", Pranë Liceut, Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX KONCEPT 2
Rruga e Elbasanit, pranë Ambasadës Amerikane, Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX LIVING
Bulevardi "Zogu I", Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX VICTORIAM
Aleksandri i Madh, Pallati Y&S, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri.

RE/MAX VIZION
Rruga e Kavajës, Kompleksi Delijorgji, Tiranë, Shqipëri.

FUTURE HOME 21 DHJETORI
Rruga "Muhamet Gjollesha", Tiranë, Shqipëri.

FUTURE HOME INTEGRITY
Rruga "Ali Demi", pranë Shkollës 1 Maji, Tiranë, Shqipëri.

FUTURE HOME KOMUNA
Rruga "Sulejman Delvina", Komuna e Parisit, Tiranë, Shqipëri.

FUTURE HOME LIQENI
Rruga "Peti", Liqeni i Thatë, Tiranë, Shqipëri.

FUTURE HOME OPPORTUNITY
Rruga e Barrikadave, Tiranë, Shqipëri.

FUTURE HOME OPPORTUNITY +
Rruga "Sotir Caci", Fresk, Tiranë, Shqipëri.

FUTURE HOME UNAZA
Rruga "Teodor Keko", Unaza e Re, Tiranë, Shqipëri.

CENTURY 21 METROPOL
Rruga "Ibrahim Rugova", Pallati Shallvare, Kati 1, Ap. 42, Tiranë, Shqipëri.

CENTURY 21 ALBANIA
Rruga "Brigada VIII", Vila Nr. 7, Tiranë, Shqipëri.

CENTURY 21 ROYAL ALBANIA
Rruga e Dibrës, pranë Farmacisë 10, Tiranë, Shqipëri.

CENTURY 21 GLOBE
Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri.

CENTURY 21 IRG INVESTMENT REALTY GROUP
Rruga e Kavajës, pranë Proper Pizza, Pall. 123, Tiranë, Shqipëri.

C21 PREMIUM TIRANE
Rruga Shyqyri Brari, Tiranë, Shqipëri.

CENTURY 21 ATRIUM
Bulevardi Zhan D'Ark, Tiranë, Shqipëri.

REALTY PARTNER
Kompleksi Square, Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri.

REAL ESTATE "INF 93"
Hyrja Qendrore, Kullat Binjake, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Shqipëri.

DEVINF REAL ESTATE COMPANY
Rruga Myslym Shyri, Pallati nr.47, Shkalla nr.2, Tiranë, Shqipëri.

DES BLLOKU TIRANË
Rruga "Ismail Qemali", Pallati Abissnet, Ish-Blloku, Tiranë, Shqipëri.

DES ISA BOLETINI TIRANË
Rruga "Isa Boletini", Tiranë, Shqipëri.

DES PETRO NINI TIRANË
"Petro Nini", Tiranë, Shqipëri.

ISEA REAL ESTATE
Rruga "Mine Peza", Tiranë, Shqipëri.

MEI REALTY
Rruga "Abdi Toptani" Nr 3, Tiranë, Shqipëri.

MEI REALTY LAPRAKA ONE
Rruga "Gjergj Legisi", Tiranë, Shqipëri.

MEI REALTY PLAZA
Rruga "Abdi Toptani", Tiranë, Shqipëri.

Për dijeni:

SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE
Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 31 Tiranë.

KOLEGJI UNIVERSTAR I BIZNESIT (KUB)
Rruga "Vangjel Noti", Nr. 25, pranë AMC-së, Laprak, Tiranë.

Ministria e Drejtësisë është ngarkuar nga legjislacioni në fuqi me mbikëqyrjen, kontrollin, inspektimin dhe kryerjen e procedimit disiplinor për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme dhe të profesioneve të tjera të lira, të lidhura me sistemin e drejtësisë, sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm në fushën përkatëse,[1] konkretisht, parashikimet e ligjit për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme[2], të cilët parashikojnë rolin e Ministrisë së Drejtësisë për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga ndërmjetësit në ushtrimin e funksionit të tyre.

[1] Sanksionuar në nenin 6, pika 18/1, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar (në vijim "LMD").
[2] Sanksionuar në nenin 21, të ligjit nr. 9/2022 "Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme".

Ministria autorizon, ndjek dhe zbaton mekanizmat e ndëshkimit administrativ për shkeljet në këtë fushë, informon dhe bashkërendon me autoritetin përgjegjës të fushës, si dhe merr masa për zvogëlimin e rrezikut të infiltrimit dhe keqpërdorimit të veprimarisë së ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme.

Dispoziat specifike të l igjit nr. 9/2022 dhe Urdhri nr . 187, datë 04.05.2022 "Për miratimin e rregullores së programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme", përcaktojnë se, "3. *Thirrja për shprehje interesi hapet të paktën 4 herë në vit dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe qëndron e hapur për një periudhë prej 15 ditësh nga data e publikimit.*", "4. *Kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme paraqet shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit të publikimit të përcaktuar në pikën 3 të këtij urdhri.*"

Me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 619, datë 23.11.2022, "Për përzgjedhjen e institucioneve trajnuese për realizimin e programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme", të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë https://www.drejtesia.gov.al/, është vendosur se institucionet do të zhvillojnë trajnimin e detyrueshëm për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme janë **KUB (Kolegji Universitar i Biznesit)** dhe **ASPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike)**.

Sa më sipër, Ministria e Drejtësisë ju njofton se në datën 25 (njëzet e pesë) Janar do të hapet thirrja për shprehje interesi dhe jeni të lutur, të njoftoni kandidatët për ndërmjetës që paraprakisht të zhvillojnë trajnimin e detyrueshëm në institucionet përkatëse dhe sipas datës së pubikimit të thirrjes për shprehje interesi së bashku me dokumentacionin përkatës, të bashkëlidhin dhe certifikatën e përfundimit të trajnimit të dhënë nga institucionet trajnuese.[3]

Pas 15 ditëve nga përfundimi i afatit të publikimit të thirrjes për shprehje interesi, struktura përkatëse e Ministrisë së Drejtësisë do të vijoj me inspektime pranë Personave Fizik dhe Juridik që kryejnë veprime juridike me pasuritë e paluajtshme dhe për subjektet që konstatohet se ushtrojnë aktivitetin pa certifikatën e ushtrimit të aktivitetit të ndërmjetësimit, do të ndëshkohen me masë administrative me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë sipas nenit 37 pika 1, të ligjit nr. 9/2022 "Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme".

***Në vëmendjen tuaj**: Ky njoftim është i vlefshëm edhe për subjektet e tjera (Persona Fizik, Juridik) që ushtrojnë profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme.*

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Ismail Shehu

[3] Pika 5 e Urdhrit nr. 187, datë 04.05.2022 "Për miratimin e rregullores së programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme"